

Përvetësimi i gjuhës në mërgim
nga Dr. Rudolf de Cillia

Përvetësimi i gjuhës në mërgim

„Nuk dua që fëmija im të mësojë turqisht (kroatisht, serbisht, gjuhën boshnjake,...) etj. Duhet të mësojë sa më shpejt gjermanisht. Pjesëmarrja në mësimin e gjuhës amtare nuk bën gjë tjetër përveç se e pengon.“

„Gjuhën amtare fëmija edhe kështu e di, nuk është e nevojshme ta mësojë. E flasim në familje.“

„Duhet t'u ndalohet fëmijëve të huaj të bisedojnë me njëri-tjetrin në gjuhën e tyre. Kjo i pengon në mësim të gjuhës gjermane.“

„Fëmijët nuk përfitojnë gjë nga njohuritë e kroatishtes (turqishtes, serbishtes, të gjuhës boshnjake, ...), më mirë ta mësojnë mirë gjermanishten dhe anglishten. Këto gjuhë u nevojiten në të ardhmen.“

Argumenta të tilla mund t'i keni dëgjuar kështu ose në një mënyrë të ngjashme. Të gjitha këto janë deklarata mbi përdorimin e dy gjuhëve dhe mbi ndikimet që ka mbi zhvillimin e fëmijëve ose mbi vlerën e gjuhëve amtare të fëmijëve të imigrantëve.

Në vazhdim do të paraqitet shkurtimisht vështrimi i gjuhësisë së aplikuar dhe i hulumtimeve në fushën e përvetësimit të gjuhës në lidhje me zhvillimin gjuhësor të fëmijëve minoritarë me dy gjuhë, sidomos të fëmijëve të imigrantëve dhe të familjeve të mërgimtarëve, gjuha amtare e të cilëve në përgjithësi është një gjuhë minoritare me një prestigj të ulët gjuhësor.

Roli i gjuhës amtare për përvetësimin e gjuhës në përgjithësi

Roli qëndror i gjuhës amtare ose të parë¹ për zhvillimin gjuhësor të një fëmije dhe për suksesin shkollor njihet së paktën nga vitet gjashtëdhjetë nga të gjithë pedagogët. Atëherë u konstatua në të ashtuquajturin „diskutim mbi barrierat gjuhësore“ se fëmijët nga shtresat sociale më të ulëta, në territorin ku flitet gjermanisht edhe fëmijët që flasin një dialekt si gjuhë amtare, kanë një disfavor në shkollat e orientuara sipas normave të shtresës së mesme dhe sipas gjuhës letrare (krahaso Bernstein 1970; Oevermann 1972).

Përveç rasteve të ralla të një bilinguizmi të hershëm „të vërtetë“, siç ndodhet kur fëmija përvetëson njëkohësisht dy gjuhë (p. sh. për arsyen se prindërit nuk kanë të njëjtën gjuhë amtare), një fëmijë përvetëson fillimisht gjuhën e parë. Mësimi i gjuhës së parë fillon me lindjen, nëse jo në fazën para lindjes, dhe përvetësimi i bazave të gramatikës është i kryer në shumicën e rasteve afërsisht me arritjen e moshës shkollore. Aktualizimi dhe nxitja e aftësisë së përvetësimit të një gjuhe të parë, aftësi kjo që është specifike për njeriun, njihja paralele me një botë të caktuar gjuhësore dhe kulturore hedhin themelin për përvetësimin e gjuhëve të tjera të dyta/të huaja. Kuptohet se përvetësimi i gjuhës amtare nuk është i kryer me hyrjen në shkollë. Fusha të rëndësishme të gramatikës, të fjalorit dhe natyrisht drejtshkrimi duhet të plotësohen ose të mësohen gjatë socializimit shkollor.

Prandaj përvetësimi i gjuhës amtare duhet të zhvillohet më tej në shkollë dhe nuk duhet të ndërpritet, sepse kjo ka pasoja jo vetëm për zotërimin e gjuhës amtare, por edhe për zhvillimin e aftësive kognitive të përgjithshme.

Saktësisht kjo ndodhet shpesh te fëmijët që i përkasin një minoriteti gjuhësor: Zhvillimi i gjuhës amtare ndërpritet në një mënyrë pak a shumë të menjëhershme me hyrjen në shkollë. Përvetësimi i mëtejshëm i gjuhës L1 nuk mund të përkrahet pothuajse fare. Fëmijët mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë në një gjuhë të dytë ose të huaj, ata që kanë gjuhën boshnjake, serbe, kroate, shqipe, turke etj. si gjuhë amtare dhe të familjes alfabetizohen p. sh. në gjuhën gjermane.

¹ Për gjuhën në të cilën bëhet socializimi i parë përdoren disa nocione të ndryshme: „gjuhë amtare“ ose „gjuhë e parë“, „gjuhë primare“, nganjëherë edhe „gjuhë familjare“. Në vazhdim do të përdoret nocioni i gjuhës amtare që përdoret zakonisht në diskutim si sinonim për gjuhën e parë, L1.

Kjo ka si pasojë që as njëra as tjetra gjuhë nuk mund të zhvillohet plotësisht, sepse alfabetizimi dhe socializimi shkollor bëhen në gjuhën e dytë dhe jo në gjuhën e socializimit të parë dhe të familjes, domëthënë ka një thyerje në zhvillimin gjuhësor. Rezultati është një fenomen që njihet me nocionin pak të diskutueshëm të „semilingualizmit“ (Skutnabb-Kangas 1983). Është fjala për një socializim gjuhësor jo të plotë, të mbetur në mes, një bilinguizëm, në të cilin për shkak të ecurisë së pafavorshme as njëra as tjetra gjuhë dhe prandaj as aftësia për të përvetësuar një gjuhë në përgjithësi nuk patën mundësinë për t'u zhvilluar plotësisht.

Kjo njohuri e pamjaftueshme e gjuhës amtare dhe e gjuhës së dytë shpesh herë nuk mund të konstatohet në sipërfaqe. Fëmijët nuk dallohen në kompetencën e tyre në gjuhën e dytë, në rastin tonë në gjuhën gjermane, gjatë komunikimit të përditshëm. Shpesh deficitet del në pah shumë më vonë, kur të ashtuquajturit aftësi gjuhësore „akademike kognitive“ fillojnë të luajnë një rol, kur është e nevojshme të përdorin p. sh. nocione abstrakte. Edhe për arsyen se aftësia e njeriut për të mësuar gjuhë natyrore duke përpunuar të dhënat gjuhësore të ambientit që e rrethon, aftësia e tij për të përvetësuar një gjuhë në përgjithësi, është e pandarshme, deficitet e socializimit të tij në gjuhën amtare kanë pasoja negative edhe në përvetësimin e çdo gjuhe tjetër. Cummins (1979) e shpjegon këtë nëpërmjet teorisë së tij të „varësisë reciproke“. Aftësitë gjuhësore (niveli i kompetencës dhe i performancës) që dikush mund të arrijë në një gjuhë të dytë ose të huaj varen shumë nga niveli që dikush ka arritur në gjuhën e tij amtare.

Rezultatet e hulumtimeve të bilinguizmit

Fakti se gjuha amtare luan një rol qëndror në procesin e përvetësimit të gjuhës në përgjithësi, patjetër edhe të gjuhës së dytë, domëthënë në rastin e fëmijëve minoritarë në përgjithësi të gjuhës zyrtare, mund të shihet veçanërisht në rezultatet e hulumtimit të bilinguizmit që merret me studimin e arritjeve gjuhësore dhe shkollore të fëmijëve dygjuhësh. Ekziston një numër i madh studimesh të tilla që janë të dokumentuara me shumë detaje p. sh. te Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner (1985).

Cummins (1979) për shëmbull arrin në studimet e tij mbi përvetësimin e aftësisë së të lexuarit rrjedhshëm në konkluzion se në rastin e përvetësimit normal të gjuhës nuk përvetësohet vetëm një gjuhë e caktuar, por aftësia për të folur një gjuhë në përgjithësi. Aftësitë gjuhësore akademike kognitive në gjuhën e parë dhe të dytë mund të kuptohen si manifestime të të njëjtit dimension bazë. Në qoftë se nuk nxiten siç duhet, fillon një rreth vicioz: Aftësia gjuhësore akademike kognitive e kufizuar fillimisht ka si pasojë kufizimin e saj të vazhdueshëm duke kufizuar kushtet e vetënxitjes së saj. Pasojat janë rezultate të ulëta në lexim, në shkrim dhe në shkollë në përgjithësi. Deficitet duket aq më shumë sa shkolla i kërkon këto aftësi akademike kognitive, d. m. th. pjesërisht edhe shumë vonë në kurikulum.

Mungesa e nxitjes së gjuhës amtare në shkollë ka natyrisht si pasojë një zotërim të pamjaftueshëm të gjuhëve të dyta te minoritetet. Këtë e tregon veçanërisht për leximin një studim i gjërë i realizuar në 14 shtete: „U konstatua zakonisht një vonesë e theksuar në lexim, në qoftë se mësimi i leximit nuk bëhet në gjuhën amtare të fëmijës.“ (Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner 1985, f. 85)

Nga ana tjetër rezultatet e hulumtimeve tregojnë se marrja parasysh e gjuhës amtare të fëmijëve minoritarë ka si pasojë rezultate pozitive në kurrikulumin shkollor. Për sa i përket rëndësisë për të ashtuquajturit „rezultate akademike“, mund të konstatohet

se aq sa u evidentua nxitja e gjuhës amtare ka ndikuar gjithmonë jo vetëm në gjuhën e dytë, por edhe në rezultate të tjera në fusha të ndryshme. Përveç kësaj del nga rezultatet absolute se edukimi bilingual është në gjëndje për të kompensuar disavantazhin e dyfishtë të statusit të ulët social dhe të përkatësisë të një minoritet gjuhësor duke arritur qëllimin e barazisë së shanceve. (Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner 1985, f. 89)

Edhe për sa i përket rëndësisë kognitive të gjuhës amtare, duket se edukimi në dy gjuhë ndikon pozitivisht në fusha të ndryshme të inteligjencës, edhe pse një interpretim i padisku-

tueshëm i faktit se këto efekte shkaktohen nga bilinguizmi është mjaft i vështirë për t'u provuar. Përmenden p. sh. përmirësimi i aftësive analitike (aftësia për ta dalluar idenë nga emërtimi, formën nga përmbajtja e gjuhës) ose përmirësime në fushën kreative. Përveç kësaj ka rezultate në lidhje me inteligjencën sociale (një përshtatje të diferencuar me dëgjuesit) etj. Por kjo vetëm në qoftë se kushtet, p. sh. në familje, janë të favorshme, në qoftë se mund të flitet për një bilinguizëm të ekuilibruar.

Në rastin e semilingualizmit kemi efektin e kundërt: Mungesat e socializimit shkollor rezultojnë në një njohuri të pamjaftueshme të gjuhës amtare dhe të gjuhës së dytë edhe kjo shpesh bëhet e kuptueshme vetëm atëherë

kur një fëmijë duhet të kuptojë dhe të përdorë nocione abstrakte. Si pasojë semilingualizmi është i shoqëruar nga një dështim shkollor. Mosarritja e standartit shoqëror shkakton gjithashtu cenime në fushën emocionale kështu që semilingualizmi duhet të konsiderohet si një sindromë që e prek në përgjithësi personalitetin. (Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner 1985, f. 19)

Së fundit nxitja e gjuhës amtare të fëmijëve me dy gjuhë në një situatë minoritare ka pasoja edhe mbi nivelin *afektiv*. Fëmija zhvillon një ndjenjë dinjiteti të minoritetit, një qëndrim pozitiv ndaj grupit të vet; përveç kësaj shfaqen efekte positive edhe te variablet afektive me rëndësi për shkollën, siç janë motivacioni, mundësimi i kontaktit midis shkollës dhe familjes etj.

Ndikimi i rëndësishëm i gjuhës amtare do të ilustronet nëpërmjet një shembulli: Rehbein (1987) informon mbi një studim me fëmijë në Hamburg gjuha amtare e të cilëve ishte turqishtja. Fëmijëve u ishte dhënë detyra për të ritreguar një tregim në gjuhën gjermane. Një grup kishte dëgjuar tregimin vetëm gjermanisht, grupit tjetër i ishte treguar turqisht. Grupi i dytë, në të cilin recepcioni ishte bërë nëpërmjet gjuhës amtare dhe të kuptuarit e tekstit ishte plotësisht i siguar, kishte rezultate shumë më të mira sesa grupi tjetër. Ky shembull tregon se mungesat në të kuptuarit të tekstit të dëgjuar kanë si pasojë natyrisht edhe mungesa të prodhimit gjuhësor në gjuhën e dytë, ndërsa ku të kuptuarit ishte i siguar edhe shprehjet produktive në gjuhën e dytë, në gjermanishten, ishin më të mira. Kur e formulojmë në një mënyrë më të përgjithshme: Në qoftë se aftësi gjuhësore të caktuara (siç janë të kuptuarit në dëgjim ose në lexim) nuk fitohen dhe zhvillohen siç duhet në L1, atëherë aftësitë përkatëse nuk mund të lirohen as në L2.

Konsekuencat pedagogjike

Prandaj literatura mbi bilinguizmin dhe shumica e rezultateve nga hulumtimet e përvetësimit të gjuhës janë në favor të një mësimi në gjuhën e parë të fëmijëve me një gjuhë amtare që nuk është gjermanishtja dhe për një edukim në dy gjuhë, sidomos për arsye se fëmijët edhe kështu janë dygjuhësh dhe ky bilinguizëm duhet të zhvillohet dhe të nxitet që të mos stërkeqet. Përmendim edhe një herë argumentat kryesore:

- Përvetësimi i gjuhës amtare njëkohësisht me gjuhën e mësimi/gjuhën e dytë (në rastin tonë me gjermanishten) në shkollë nuk e pengon përvetësimin e gjuhës së dytë, por për kundrazë:
- Një gjuhë e parë stabile e nxit dhe e lehtëson përvetësimin e gjuhës së dytë dhe të të gjitha gjuhëve të tjera.
- Aftësia e analizës gjuhësore si edhe cilësia dhe sasia e strategjive për përvetësimin e një gjuhe janë më të larta te fëmijët me dy gjuhë sesa tek ata me një gjuhë.
- Nxitet krijimtaria gjuhësore.
- Mund të konstatohen ndikime pozitive mbi performancat e inteligjencës verbale dhe joverbale.
- Së fundit përmenden toleranca më e madhe e njerëzve me dy gjuhë dhe predispozita e tyre më e vogël për një etnocentrizëm.

Në Austri p. sh. ka me Boeckmann (1997) një studim empirik që konfirmon të gjitha këto aspekte: domethënë fëmijët e edukuar në shkollat e Burgenland-it në dy gjuhë (është fjala për fëmijë që kishin kroatishen ose hungarishten si gjuhë amtare) jo vetëm nuk kishin mangësi shkollore, por për kundrazi paraqitnin përveç avantazhit të një kompetence në dy gjuhë edhe një zhvillim kognitiv mbi mesataren. Edhe fëmijët e edukuar në një gjuhë (në gjuhën e shumicës së popullsisë) përfitojnë – sipas rezultateve të këtij studimi – nga fakti se ndjekin shkolla dygjuhëshe. Rezultate të ngjashme kishte vlerësimi i eksperimenteve shkollore në lidhje me alfabetizimin dygjuhësh (gjermanisht – turqisht) në Berlin (krahaso Nehr/Karajoli 1995).

Këto njohuri janë aplikuar disa herë në vitet e fundit për të organizuar mësimin e gjuhëve të huaja në një mënyrë më efektive. Kështu u krijuan shkolla dygjuhëshe në të cilat mësimi bëhet që nga fillimi i detyrimit shkollor në dy gjuhë. Në Austri ka prej disa vjetve një „Vienna Bilingual School“, në të cilën mësimi bëhet nga klasa e I-rë e shkollës fillore në gjuhën gjermane dhe angleze.

Në rastin e minoritarëve gjuhët amtare të të cilëve janë të rrezikuara (edhe kjo ndodhet si rregull në situatën e mërgimit), nxitja e tyre në sistemin edukativ është veçanërisht e rëndësishme. Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner (1985) shkruajnë në lidhje me këtë problem:

Kjo nxitje është parimisht e nevojshme, në qoftë se ekziston dëshira për ta përmirësuar performancën gjuhësore dhe shkollore dhe për të arritur të një zhvillim më pozitiv në fushën afektive. Duhet një nxitje intensive brenda një kohe të gjatë që përfshin edhe përdorimin e gjuhës amtare si mjet të mësimin, në qoftë se ekziston dëshira për të kompensuar dy variable të pafavorshme të prognozës: përkatësinë të një minoritet gjuhësor dhe – në shumicën e rasteve – statusin e ulët socio-ekonomik. (Fthenakis/Sonner/Thrul/Walbiner 1985, f. 108)

Prandaj çdo gjë është në favor të asaj që gjuhët amtare të këtyre fëmijëve të merren parasysh në një mënyrë sa më të gjerë. Për këtë ka modele shkollore të ndryshme: grupe/klasa dygjuhëshe të veçanta nga njëra anë, një përfshirje sa më të gjërë të këtyre gjuhëve në sistemin shkollor të përgjishshëm nga ana tjetër, siç është rasti i modeleve të alfabetizimit në dy gjuhë në hapësirën gjermanfolëse (p. sh. në Berlin) që mund të konsiderohet si një eksperiment i suksesshëm i një përpjekjeje të tillë integrative dhe shumëkulturore. Alfabetizimi në gjuhën amtare dhe një mësim i mjaftueshëm i gjuhës amtare së paktën gjatë tre, katër vjetve të parë të detyrimit shkollor, në rastin më të mire përdorimi i gjuhës L1 si gjuhë e dytë mësimore, janë kërkesat minimale për një nxitje të gjuhës amtare.

Përmbledhje

Rikthehemi te thëniet e cituara në fillim:

- Thënia se fëmija edhe kështu e di gjuhën amtare dhe nuk duhet ta mësojë nuk është e saktë. Zhvillimi gjuhësor nuk mbaron në asnjë mënyrë me moshën kur fëmija hyn në shkollë dhe përdorimi i gjuhës vetëm në familje nuk mjafton për ta zhvilluar atë më tej. Një zhvillim i gjuhës L1 që ngel në vend mund të ketë pasoja fatale për mësimin e gjuhëve të tjera dhe për zhvillimin intelektual të fëmijës në përgjithësi.
- Po ashtu edhe thënia se mësimi i gjuhës amtare e pengon mësimin e gjuhës së dytë, të gjermanishtes, është një konkluzion i gabuar. Veçanërisht kur nuk merret parasysh siç duhet gjuha amtare zhvillohet i ashtuquajturi „semilingualizëm“ që mund të ketë më vonë pasoja negative në të gjitha dimensionet e performancave shkollore.
- Kur u ndalohet fëmijëve të bisedojnë në shkollë në gjuhën e tyre amtare qoftë në pushim qoftë në mësim, kjo tregon jo vetëm një mungesë sensitiviteti dhe njëfarë arrogance etnocentriste, por kjo e pengon edhe mundësinë që të sigurohet të kuptuarit e lëndës, në qoftë se nuk lejohet që fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Përvetësimi i gjuhës gjermane që edhe kështu është kudo e pranishme nuk mbetet prapa në këtë rast, për kundrazi ai përkrahet.

- Së fundit njohuritë e gjuhëve amtare të fëmijëve të mërgimtarëve nuk janë në asnjë mënyrë pa dobi, në shumë profesione sociale dhe në shërbime, p. sh. në polici, në spitale etj., kërkohen njerëz me dy gjuhë. Për ata njohuritë e gjuhëve të tyre amtare bëhen një kualifikim shtesë që i dallon në tregun e punës nga bashkëkonkurruesit dhe bashkëkonkurrueset me vetëm një gjuhë.

Ç'farë mund të bëjnë mësueset dhe mësuesit e të gjitha lëndëve për ta nxitur zhvillimin gjuhësor të fëmijëve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjermanishtja, në qoftë se ata nuk ndjekin mësimin e gjuhës amtare?

- Ata mund t'i informojnë prindërit e fëmijëve kur të ketë mundësi (gjatë regjistrimit të fëmijëve, në mbrëmjet e prindërve, ditët e konsultimeve etj.) mbi rëndësinë e përdorimit të gjuhës amtare, p. sh. edhe në familje, dhe mbi konkluzionet e gabuara të përmendura më lart.
- Ata mund ta lejojnë përdorimin e gjuhëve amtare mes njëri-tjetrit jo vetëm në bisedat e pushimeve, por edhe në mësim, në rastin e një pune që bëhet në grup ose me një partner.
- Mësueset ose mësuesit mund të mësojnë dhe të përdorin vetë disa shprehje (p. sh. mënyrat e përshëndetjes) në gjuhët amtare të fëmijëve për ta rritur prestigjin e tyre dhe për ta nxitur përdorimin e më shumë gjuhëve nga ana e fëmijëve.
- Ata mund të kujdesen për një prani sa më të madhe të të gjitha gjuhëve të folura në shkollë, p. sh. nëpërmjet ftesave të prindërve në gjuhët amtare për mbrëmjet e prindërve, materialit të leximit në gjuhët amtare në bibliotekat e shkollave ose sipas mundësive dhe në rast nevojë nëpërmjet një përkthimi gjatë bisedave me prindërit.
- Mund të përfshijnë në lëndën e masmediave edhe materiale në gjuhët amtare që mund të gjënden në Austri.
- Realizimi i parimit të „të mësuarit ndërkulturor“ në mësim dhe përfshirja eksplicite e gjuhëve amtare në mësim, p. sh. nëpërmjet krahasimeve të gjuhëve, këngëve, fjalëve të urta etj. Nxënësit dhe nxënëset duhet të aktivizohen në hartimin e teksteve edhe në gjuhën amtare (p. sh. poezi, ditarë). Sipas mundësive këto tekste mund të lexohen në klasë. Prania reale e më shumë gjuhëve duhet të jetë e dukshme edhe në klasë, p. sh. në zbukurimin e klasës.

Literaturhinweise des Referats für Migration und Schule

1. Für den Unterricht

Grundstufe

bm:ukk (Hg.): TRIO. Drei Sprachen, eine Schule. Das Kindermagazin für den Unterricht in mehrsprachigen Klassen (2. bis 4. Schulstufe). Erscheint zweimal jährlich.

bm:bwk und Österreichisches Sprachenkompetenzzentrum (Hg.): Zoom. Fremdsprachenlernen in der Grundschule. Heft 7 neu. In den Sprachen Bosnisch/Kroatisch/Serbisch, Burgenland-Kroatisch, Englisch, Französisch, Italienisch, Slowakisch, Slowenisch, Tschechisch, Türkisch, Ungarisch. Graz 2005.

Sekundarstufe I

bm:bwk (Hg.): Interkulturelles Lernen – Mathematik (vier Bände für die 5. bis 8. Schulstufe). Mit Textbeispielen in drei Sprachen. 2. aktualisierte Auflage. Von Helmut Breit. Wien 2006.

bm:ukk, Stadtschulrat für Wien und Pädagogisches Institut der Stadt Wien (Hg.): Leselust statt Lesefrust. Ein Leseprojekt für die Sekundarstufe I speziell für Kinder mit Migrationshintergrund. 2. Auflage. Wien, Jänner 2008.

Bottazzi, Mario, Karin Wolf und Maria Zangl: Rap'n'learn. Deutsch-Grammatiktraining. Helbling, Rum/Innsbruck 1999.

Icelly, Monika und Tatjana Sprenger: Texte 1: Auf einer Wolke liegen... E. Dorner Verlag 2009. Schulbuchliste. Mit einigen fremdsprachigen Texten!

Icelly, Monika und Tatjana Sprenger: Texte 2: Zwischen den Welten... E. Dorner Verlag 2009. Schulbuchliste. Mit einigen fremdsprachigen Texten!

Schader, Basil: Sprachenvielfalt als Chance. 101 praktische Vorschläge. Bildungsvorlag EINS/Orel Füssli, Troisdorf 2004.

2. Zur eigenen Weiterbildung

Bücher und Zeitschriften

Ahrenholz, Bernt und Ingelore Oomen-Welke (Hg.): Deutsch als Zweitsprache. Schneider Hohengehren, Baltmannsweiler 2008. (= Deutschunterricht in Theorie und Praxis 9)

Brizić, Katharina: Das geheime Leben der Sprachen. Gesprochene und verschwiegene Sprachen und ihr Einfluss auf den Spracherwerb in der Migration. Waxmann, Münster 2007.

Busch, Brigitta und Thomas: Mitten durch meine Zunge. Drava, Klagenfurt/Celovec 2008.

Busch, Brigitta und Thomas (Hg.): Von Menschen, Orten und Sprachen. Drava, Klagenfurt/Celovec 2009.

Czernilofsky, Barbara und Georg Kremnitz (Hg.): Trennendes – Verbindendes. Selbstzeugnisse zur individuellen Mehrsprachigkeit. Edition Praesens, Wien 2003.

Erziehung & Unterricht, Nr. 1-12/2011: Abschied von Monolingualismus und Monokulturalismus. Österreichischer Bundesverlag, Wien 2011.

Fremdsprache Deutsch. Zeitschrift für die Praxis des Deutschunterrichts. Heft 38/2008: Sprachen lernen – Theorien und Modelle.

Furch, Elisabeth und Harald Eichelberger (Hg.): Kulturen – Sprachen – Welten. 2. überarbeitete und ergänzte Neuauflage, Studienverlag, Innsbruck – Wien 2008.

ide – Informationen zur Deutschdidaktik, Nr. 2/2008: Mehrsprachigkeit im Deutschunterricht.

ide – Informationen zur Deutschdidaktik, Nr. 2/2005: Sprachbegegnungen.

Klann-Delius, Gisela: Spracherwerb. 2., aktualisierte und erweiterte Auflage. Metzler, Stuttgart 2008.

Krumm, Hans-Jürgen: Kinder und ihre Sprachen – lebendige Mehrsprachigkeit. eviva, Wien 2001. Vergriffen, aber in Bibliotheken erhältlich.

Leist-Villis, Anja: Elternratgeber Zweisprachigkeit. Informationen & Tipps zur zweisprachigen Entwicklung und Erziehung von Kindern. Stauffenberg Verlag, Tübingen 2008.

Montanari, Elke: Mit zwei Sprachen groß werden. Kösel, München 2003.

ÖDaF-Mitteilungen, Heft 2/2008: Mehrsprachigkeit.

Plutzer, Verena und Nadja Kerschhofer-Puhalo (Hg.): Nachhaltige Sprachförderung. Studienverlag, Innsbruck – Wien 2009.

Portmann-Tselikas, Paul R.: Sprachförderung im Unterricht. Handbuch für den Sach- und Sprachunterricht in mehrsprachigen Klassen. Orel Füssli Verlag, Zürich 1998.

Portmann-Tselikas, Paul R. und Sabine Schmölzer-Eibinger (Hg.): Grammatik und Sprachaufmerksamkeit. Band 6 der Reihe „Theorie und Praxis – Österreichische Beiträge zu Deutsch als Fremdsprache“ Studienverlag, Innsbruck – Wien 2001.

Rieder, Karl: Linguistik für Lehrerinnen und Lehrer. Pädagogisches Wissen aktuell. öbv & hpt, Wien 2001.

Rieder, Karl: Fehler in Schülertexten analysieren. Pädagogisches Wissen aktuell. öbv & hpt, Wien 2001.

Rieder, Karl: Intercomprehension. Fremdsprachige Texte entschlüsseln. Pädagogisches Wissen aktuell. öbv & hpt, Wien 2001.

Sträuli Arslan, Barbara: Leseknick – Lesekick. Leseförderung in vielsprachigen Schulen. Lehrmittelverlag des Kantons Zürich 2005.

Tracy, Rosemary: Wie Kinder Sprachen lernen. 2. Auflage, Francke Verlag 2008.

Artikel

Boeckmann, Klaus-Börge: Drei Halbwahrheiten über Zweitsprachen. In: Erziehung und Unterricht, Nr. 1-2/2008.

Busch, Brigitta: Bosnisch, Kroatisch, Serbisch, Serbokroatisch, Jugoslawisch, Romani oder Vlachisch? Heteroglossie und 'muttersprachlicher' Unterricht in Österreich. In: Gelebte Mehrsprachigkeit. Praesens Verlag, Wien 2006.

de Cillia, Rudolf: Deutsch als Zweitsprache – Spracherwerb in der Migration. In: tribüne. zeitschrift für sprache und schreibung, Nr. 2/2006

Ehlers, Swantje: Lesen in der Zweitsprache und Fördermöglichkeiten. In: Deutschunterricht 47/2004.

Fleck, Elfie: Der muttersprachliche Unterricht. Schulrechtliche und schulorganisatorische Rahmenbedingungen. Schriftliche Fassung eines Vortrags gehalten am 18. Juni 2009 in Innsbruck.

Fleck, Elfie: Wie viel Muttersprache braucht ein Kind? In: Jugend und Medien 2/2003-2004.

Krumm, Hans-Jürgen: Pausenlos Deutsch – Sprachzwang und sprachliche Identität. In: tribüne. zeitschrift für sprache und schreibung, Nr. 2/2006

Mayer, Werner: Migrantenkinder – Bildungskarrieren. In: Erziehung und Unterricht, Nr. 3-4/2006.

Stefan, Ferdinand: Neun „Gebote“ zum sprachlichen Umgang mit Migrantenkindern. In: Furch, Elisabeth (Hg.): C.A.N.E. – Cultural Awareness in Europe. Lernen mit Pfiff, Wien 2003.

Sämtliche Artikel sind im Referat für Migration und Schule gegen Bestellung per E-Mail kostenlos erhältlich.

„Klassiker“

Boeckmann, Klaus-Börge: Zweisprachigkeit und Schulerfolg. Das Beispiel Burgenland. (Arbeiten zur Sprachanalyse 26). Peter Lang, Frankfurt/Main 1997.

de Cillia, Rudolf: Mehrsprachigkeit und Herkunftssprachenunterricht in europäischen Schulen. In: Çınar, Dilek (Hg.): Gleichwertige Sprachen? Muttersprachlicher Unterricht für die Kinder von Einwanderern. Studienverlag, Innsbruck – Wien 1998.

Fthenakis, Wassilios E., Adelheid Sonner, Rosemarie Thrul, Waltraud Walbinger (Hg.): Bilingual-bikulturelle Entwicklung des Kindes. Ein Handbuch für Psychologen, Pädagogen und Linguisten. Hueber, München 1985.

Gogolin, Ingrid: Der monolinguale Habitus der multilingualen Schule. Waxmann, Münster 1993.

Oksaar, Els: Zweitspracherwerb. Wege zur Mehrsprachigkeit und zur interkulturellen Verständigung. Kohlhammer Verlag, Stuttgart 2003.

Luchtenberg, Sigrid: Interkulturelle sprachliche Bildung: Zur Bedeutung von Zwei- und Mehrsprachigkeit für Schule und Unterricht. Waxmann, Münster 1995.

Skutnabb-Kangas, Tove: Bilingualism or Not. The Education of Minorities. Clevedon 1983.

3. Internetadressen [Zugriff: 4. 10. 2010]

www.bmukk.gv.at → Bildung – Schulen → Unterricht und Schule → Lehrpläne

www.bmukk.gv.at → Bildung – Schulen → Unterricht und Schule → Bildungsanliegen → SchülerInnen mit anderen Erstsprachen als Deutsch

www.trio.co.at: die Website zur dreisprachigen Kinderzeitschrift TRIO

www.buch-mehrsprachig.at: elektronische Empfehlungsliste fremd-, zwei- und mehrsprachiger Kinder- und Jugendliteratur

www.sprachensteckbriefe.at: Überblick über Verbreitung, Geschichte und Struktur der häufigsten in Österreich gesprochenen Migrantensprachen

www.muttersprachlicher-unterricht.at: die Website für die muttersprachlichen LehrerInnen: Wissenswertes zum muttersprachlichen Unterricht, Materialienbörse, aktuelle Veranstaltungen

www.projekte-interkulturell.at: Dokumentation von Projekten im Rahmen der Schulaktion *Interkulturalität und Mehrsprachigkeit – eine Chance!*

www.woerterwelt.at: Online-Wörterbücher und Übungen, auf Deutsch, Albanisch Bosnisch/Kroatisch/Serbisch, Slowakisch, Tschechisch und Türkisch

<http://daz.schule.at>: Österreichs Schulportal für Deutsch als Zweitsprache und interkulturelles Lernen

www.sprich-mit-mir.at: die bm:ukk-Website zur frühen sprachlichen Förderung

www.oesz.at: die Website des österreichischen Sprachenkompetenzzentrums

<http://kleine-eule.osttirol.net>: „Die kleine Eule“ von Lene Mayer-Skumanz auf Deutsch und in 39 weiteren Sprachen

Für weitere Auskünfte stehen Ihnen die Mitarbeiterinnen
des Referats für Migration und Schule zur Verfügung:

Mag. Elfie Fleck
Mag. Anna Lasselsberger
Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur
Abt. I/5a
Referat für Migration und Schule
Minoritenplatz 5
A – 1014 Wien
Tel.: 01/53-120/25-52 oder 25-28
Fax: 01/53-120/25-99
E-Mail: elfie.fleck@bmukk.gv.at
anna.lasselsberger@bmukk.gv.at

Impressum:
Herausgeber und Medieninhaber:
Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur
Abt. I/5a, Referat für Migration und Schule
14. aktualisierte Auflage
Wien, September 2011